



AVOKATI I POPULLIT



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AVOKATI I POPULLIT
Seksioni i Përgjithshëm

Adresa: Bulevardi: "Zhan D'Ark" Nr.2
Tiranë, Shqipëri

Tel/Fax: +355 4 2380 300/315
E-mail: ap@avokatipopullit.gov.al
www.avokatipopullit.gov.al

Nr. Prot.
Nr. Dok. 202002458/2

Tiranë ___/___/2020

Lënda: *Rekomandim për marrjen e masave të menjëherëshme, për kryerjen e testeve për COVID-19, për studentët shqiptarë që ndjekin studimet parauniversitare dhe universitare jashtë vendit.*

Drejtuar: **Zj.Ogerta MANASTIRLIU**

Ministre e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale

Tiranë

E nderuar zonja ministre,

Prej vitesh në Shqipëri ka tendenca në rritje të numrit të të rinjve për të studiuar jashtë vendit si në vendet perëndimore ashtu edhe në ato lindore. Protagonistë të botës akademike nënvizojnë se fenomeni ka marrë përmasa të qënësishme, duke e kategorizuar atë si rrjedhje të trurit. Shkaqet e këtij fluksi në rritje janë nga më të ndryshmet, por në përgjithësi të tilla konsiderohen si rënia e cilësisë së arsimit të lartë në Shqipëri, dëshira për të marrë një edukim më të mirë, mangësitë me tregun e punës cilësisë së arsimit të lartë, gjendja ekonomike etj. Shqipëria po përballet në vijimësi me fenomenin e rrjedhjes së trurit ndërsa kritikët e shohin këtë fenomen si largim të energjive, dijeve dhe vullnetit për ndryshim. Të gjithë këta tregues duhet të na bëjnë pesimistë dhe të na ndërgjegjësojnë të gjithëve si shoqëri për të bërë maksimumin që këta të rinj të kthehen dhe kontribuojnë në vendin e tyre, në të gjitha aspektet e jetës dhe një nga mënyrat për ta bërë këtë gjë është të mos u krijojmë barriera por edhe duke i bërë të ndejnë se mirëqenia e tyre është një shqetësim konstant i qeverisë. Kësaj shtate i është bashkuar tashmë edhe pandemia e cila ka lëkundur ekuilibrat në të gjitha sferat e jetës, si në Shqipëri ashtu edhe në të gjithë botën. Në këtë aspekt me lejoni të shpreh mbështjen time për punën jo të lehtë të bërë në kuader të përbalimit të emergjences shëndetësore, të bindur se kemi ende jo pak sfida të reja përpara.

Ashtu sikundër dihet, jeta shkollore dhe universitare që prej muajit Mars 2020 u transformua në ndjekjen on-line të studimeve në rang kombëtar dhe ndërkombëtar. Kjo solli në pjesën më të madhe të vendeve largimin e studentëve nga konviktet apo vendet ku studionin dhe kthimin e tyre në

Shqipëri, ndonëse me vështirësi, pranë familjeve dhe frekuentimin e leksioneve dhe dhënien e provimeve vetëm on-line. Kjo është një sfidë si për nxënësit, studentët, mësuesit e stafet akademike ashtu edhe për prindërit, si një realitet i paimagjinuar më parë se do të ndodhte në këto përmasa. Kjo periudhë ndërkohë ka shërbyer edhe për të marrë masa më të mira nga institucionet arsimore nëpër botë në lidhje me ofrimin e shërbimit të mësimdhënies edhe në realitet të ri, post Covid 19.

Si të gjitha institucionet shtetërore në përpjekje maksimale në kushtet dhe realitetin shqiptar, edhe Institucioni i Avokatit të Popullit është duke monitoruar me shumë vëmendje masat e marra nga autoritetet shqiptare për përballimin me sukses të pandemisë së Covid-19.

Kohët e fundit pranë institucionit tonë janë adresuar shumë ankesa dhe kërkesa nga të rinj që studiojnë jashtë vendit, të cilëve u kërkohet që para se të fillojnë studimet e tyre të jenë të çertifikuar nga autoritetet shëndetësore të vendit nga vijnë, që kanë kryer testin e Covid-19 dhe kanë rezultuar negativ, ndryshe nuk mund të vijojnë të frekuentojnë auditoret. Por, siç tashmë dihet, kjo gjë nuk u mundësohet lirisht qytetarëve nga institucionet shëndetësore shtetërore apo private qoftë edhe kundrejt pagesës.

Mbrojtja e shëndetit dhe e drejta për kujdes shëndetësor është një e drejtë e garantuar jo vetëm nga Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë dhe aktet ligjore në RSH, por edhe nga një sërë aktesh ndërkombëtare në të cilat vendi ynë ka aderuar, të tilla si Deklarata Universale e të Drejtave të Njeriut, Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut, Karta Sociale Evropiane, Pakti Ndërkombëtar për të Drejtat Ekonomike, Sociale dhe Kulturore, Konventa e Këshillit të Evropës për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Dinjitetit të Qenies Njerëzore në kuaër të aplikimit të Biologjisë dhe Mjekësisë, etj.

Në Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë Neni 15 dhe 55/1 parashikohet se :

- 1) *Të drejtat dhe liritë themelore të njeriut janë të pandashme, të patjetërsueshme e të padhunueshme dhe qëndrojnë në themel të të gjithë rendit juridik. 2. Organet e pushtetit publik, në përmbushje të detyrave të tyre, duhet të respektojnë të drejtat dhe liritë themelore të njeriut, si dhe të kontribuojnë në realizimin e tyre.*
- 2) *Shtetasit gëzojnë në mënyrë të barabartë të drejtën për kujdes shëndetësor nga shteti.*
- 3) *Kushdo ka të drejtë për sigurim shëndetësor sipas procedurës së caktuar me ligj.*

Gjithashtu edhe Ligji Nr. 15/2016 “Për Parandalimin dhe luftimin edhe sëmundjeve infektive”, Neni 4; përcakton parimet për parandalimin dhe luftimin e infeksioneve dhe sëmundjeve infektive si më poshtë:

- A. *parandalimi i sëmundjeve ngjitëse në territorin e Republikës së Shqipërisë është i detyrueshëm; b) parandalimi dhe luftimi i infeksioneve dhe sëmundjeve infektive ofrohet pa asnjë lloj diskriminimi;*

- B. d) mbrojtja nga sëmundjet infektive bëhet sipas një planifikimi, programimi, organizimi, zbatimi të masave për parandalimin, diagnozën, trajtimin, luftimin, zhdukjen e sëmundjeve infektive dhe sigurimin e mjeteve e infrastrukturës së domosdoshme për mbrojtjen shëndetësore ndaj tyre;
- C. dh) çdo person ka të drejtë të përfitojë nga masat për mbrojtjen nga sëmundjet infektive;
- D. e) çdo person i sëmurë nga sëmundjet infektive me karakter epidemik ka të drejtën dhe detyrimin të mjekohet falas në çdo institucion shëndetësor publik apo jopublik;
- E. ë) çdo personi të dyshuar ose të konfirmuar me sëmundje infektive, sipas një liste të përcaktuar nga Shërbimi Kombëtar i Inteligjencës Epidemike dhe Shërbimi Kombëtar i Kujdesit ndaj Sëmundjeve Infektive, të miratuar me urdhër nga ministri përgjegjës për shëndetësinë, i ofrohet shërbim shëndetësor i menjëhershëm dhe falas, pavarësisht nivelit të kujdesit shëndetësor;

Më datë 14 Prill 2020 Komiteti i Bioetikës pranë KiE ka dalë me një deklaratë lidhur me të drejtat e njeriut gjatë kohës së pandemisë¹ ku thekson disa nga parimet kryesore të të drejtave të njeriut që duhet të mbahen në vëmendje gjatë kohës së pandemisë, të tilla si barazia e aksesit në kujdesin shëndetësor, e drejta e të dhënave personale dhe informimit, etj dhe bën thirrje për veprime të koordinuara dhe që adresojnë sfidat më të mëdha etike.

Nga ana tjetër, Bashkimi Evropian ka miratuar Strategjinë e përditësuar të rihapjes për studentët që vijnë nga vendet që nuk janë anëtarë të Bashkimit Evropian, duke vendosur heqjen e kufizimit për hyrjen në territorin e BE të këtyre studentëve,² por duke përcaktuar si kriter, në pjesën më të madhe të rasteve, kryerjen e testimit për COVID-19, i cili duhet të ketë rezultuar negativ³.

Rritja e numrit të testeve të popullsisë shqiptare për virusin coronavirus, si një strategji dhe mekanizëm për mbajtjen në kontroll dhe frenimin e përhapjes së mëtejshme të kësaj sëmundje infektive, e njëherësh si një e drejtë e çdo qytetari, ju është rekomanduar edhe më parë nga Avokati i Popullit, në një rekomandim ku analizohet gjerësisht situata aktuale në vendin tonë si dhe rekomandimet ndërkombëtare në këtë drejtim.

Për sa më lart, duke marrë shkas nga nevoja reale që i penalizon këta studentë në rast të moskryerjes së testit, deri në ndërprerjen e studimeve apo moslejimin e frekuentimit të mësimave, vlerësojmë se duhen gjetur mekanizmat dhe rrugët e nevojshme dhe të domosdoshme nga ana Juaj, për t'i siguruar kësaj kategorie kryerjen e testit të COVID-19, qoftë edhe kundrejt pagesës. Ne e kuptojmë vështirësinë shumë të madhe me të cilën po përballen institucionet tona shëndetësore e jo vetëm, por nga ana tjetër mendojmë se ne si shoqëri kemi një detyrim të shtuar ndaj këtyre studentëve të cilët kanë kaluar sfida jo të vogla e kanë parë jetët e tyre të preken vrullshëm prej kësaj pandemie. Për këtë arsye mendojmë se kundrejt një tarife e cila të mbulojë kostot e shërbimit për nxënësit e kundrejt dokumentacionit justifikues në lidhje me shkollimin, të bëhet i mundur

¹ <https://rm.coe.int/inf-2020-2-statement-covid19-e/16809e2785>

² https://ec.europa.eu/info/live-work-travel-eu/health/coronavirus-response/travel-and-transportation-during-coronavirus-pandemic_en

³ <https://reopen.europa.eu/en>

testimi i tyre. Edukimi e shkollimi i të rinjve tanë në shkolla ku cilësia e edukimit u jep mundësinë të jenë një forcë për Shqipërinë e të ardhmes, dhe ne kemi detyrimin që ata ta ndjijnë se qeveria shqiptare i ka shqetësimet tyre në vëmendje.

Institucioni ynë vlerëson dhe rekomandon se shteti shqiptar duhet të marrë menjëherë masat e nevojshme, për t'u siguruar që asnjë shtetasi shqiptar, që dëshiron të bëjë testin e COVID-19, të mos t'i mohohet e drejta për ta kryer, pasi e drejta për të pasur trajtimin e duhur mbi bazën e testimin është një e drejtë e njeriut, por jemi të ndërgjegjshëm se mundësitë aktuale nuk mundësojnë zbatimin tërësor të kësaj të drejte në tërësinë e vet. Në çdo rast ne kërkojmë në të njëjten kohë të gjenden rrugët dhe zgjidhjet alternative për ta realizuar atë. Kërkesa për testim nuk mund dhe nuk duhet të jetë luks, por një e drejtë për t'u gëzuar në situatën e pandemisë që po kalojmë, si dhe përmbushje e kërkesës së universiteteve në botë për studentët shqiptarë. Ndërsa përsa i përket të rinjve të cilët duhet të nisen drejt shkollave të tyre jashtë vendit për vijuar edukimin me shpenzimet e tyre për të marrë një edukim me një cilësi që nuk ofrohet nga sistemi arsimor publik në Shqipëri, mendoj se mundësia e kryerjes së testit kundrejt një tarife shërbimi të orientuar drejt kostos duhet të jepet si mundësi nga ana e qeverisë shqiptare.

Nga ana tjetër, vlerësojmë gjithashtu se mosfrimi i këtij shërbimi do të krijojë tensione të panevojshme midis një numri jo të vogël personash dhe organeve shtetërore përkatëse, por edhe do të rrisë mundësinë e kërimit për të marrë këtë shërbim në rrugë jo të ligjshme duke bërë kështu fatkeqësisht familjet apo edhe vetë nxënësit objekt të veprimeve korruptive pasi flitet për të ardhmen e fëmijve të tyre, por edhe për investime jo të vogla të bëra nga familjet shqiptare në lidhje me shkollimin e të rinjve. Për të parandaluar sa më sipër mendojmë se ka shumë rëndësi që të merren masat e përshtatshme në kohën e duhur.

Për sa më sipër, Avokati i Popullit në vijim të kryerjes së misionit ligjor në rolin e nxitësit të standardeve më të larta të të drejtave dhe lirive të njeriut në vend, bazuar në nenin 63/3 të Kushtetutës ku parashikohet se: *“Avokati i Popullit ka të drejtë të bëjë rekomandime dhe të propozojë masa kur vëren shkelje të të drejtave dhe lirive të njeriut nga administrata publike”*; si dhe nenin 21/b të ligjit nr. 8454 datë 04.02.1999 *“Për Avokatin e Popullit”*, i ndryshuar, ku parashikohet se: *“Avokati i Popullit paraqet rekomandime për vënien në vend të së drejtës së shkelur tek organi administrativ, që, sipas tij ka shkaktuar shkelje të të drejtave dhe lirive”*,

REKOMANDON:

- **Marrjen e masave të menjëhershme, për krijimin e mundësive për kryerjen e testeve të nxënësve dhe studentëve që studiojnë jashtë vendit për COVID-19, edhe kundrejt pagesës së një tarife të orientuar drejt kostos si një e drejtë e tyre dhe një detyrim i shtetit për ta realizuar atë.**

Për qëndrimin që do të mbani ndaj këtij rekomandimi dhe masat që do të merren për zbatimin e tij, lutem të na vini në dijeni brenda afateve më të mira.

Duke besuar në mirëkuptimin dhe bashkëpunimin tuaj,

**AVOKAT I POPULLIT
ERINDA BALLANCA**